



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të vetëm të shoqërive GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA nga shoqëria RAIFFEISEN BANK SA.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 408 prot., i AK, datë 24.04.2026, “Njoftim Përqendrimi”, ku jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftrimin e kontrollit të vetëm të shoqërive GARANTI BANK SA dhe MOTORACTIVE IFN SA nga shoqëria RAIFFEISEN BANK SA.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

**Blerësi: RAIFFEISEN BANK SA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit rumun, pjesë e Grupit Raiffeisen Bank International.

Grupi RBI ofron shërbime universale bankare dhe financiare përmes disa degëve në Evropën Qëndrore dhe Lindore, si edhe shërbime të tjera financiare në fushën e qirasë, menaxhimit të aseteve etj.

Grupi RBI është prezent dhe realizon të ardhura në Shqipëri përmes RAIFFEISEN BANK SHA.

**Shitësit:**

**Garanti Holding B.V. dhe G Netherlands B.V.** janë shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, të themeluara sipas ligjeve të Holandës.

**Target :**

**GARANTI BANK SA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit rumun.

**MOTORACTIVE IFN SA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit rumun.

**Motoractive Multiservices S.R.L.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Rumanisë, një degë plotësisht në pronësi të MOTORACTIVE IFN SA.

Shoqëritë target nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**